



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Nr. 012/2026
Datë: 15.09.2026

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 (3 dhe 10) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 9 (1.3 dhe 1.4), nenin 12, të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nxjerr:

V E N D I M

1. Z. Zef Morina, emërohet Zëvendësministër i parë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit.
2. Zëvendësministri emërohet për mbështetjen e Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit dhe është përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve në fushat e përcaktuara nga Ministri, si dhe për zëvendësimin e Ministrit kur ai mungon ose kur nuk është në gjendje të kryejë detyrën e tij.
3. Z. Morina, është i obliguar të bëjë deklarimin e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-108 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- Z. Zef Morina, Zëvendësministër i parë në MIT;
- Zëvendëskryeministrave;
- Ministrave;
- Shefes së stafit të Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.